

VENDIM
Nr. 261, datë 10.5.2021

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË VLORË, TË PRONËS ME EMËRTIMIN “DREJTORIA RAJONALE E KUFIRIT DHE MIGRACIONIT VLORË”, ME VENDNDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 8602, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 250, DATË 24.4.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Vlorë, të pronës me emërtimin “Drejtorja Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Vlorë”, me vendndodhje në zonën kadastrale 8602, me numër pasurie 28/73/5-ND, sipas fragmentit të hartës kadastrale bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim për t’u përdorur në fushën e zhvillimit ekonomik dhe multifunksional.

2. Prona me emërtimin “Drejtorja Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Vlorë”, hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, të ndryshuar.

3. Bashkisë Vlorë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve pronën e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohet “Porti Detar, Vlorë” sh.a. që të vendosë në dispozicion të Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit Vlorë ambiente të përshtatshme për të zhvilluar veprimtarinë e saj.

5. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, “Porti Detar, Vlorë” sh.a., Bashkia Vlorë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENCIA SHTETERORE E KADASTRES

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE


ZONA KADASTRALE : 8602

KODI UNIK : _____

NUMRI I PASURISË : 28/73/5-ND

INDEX I HARTES : VL-O-11

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1:500

DREJTORI :
KLODIAN TROCI

Data e leshimit : 05.05.2021
Nr Serial : _____



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Vlorë
Date: 2021/05/05 13:15:10 +02'00'
K86331391H2021050513150215014

Klodian
Troci

Digitally signed by
Klodian Troci
Date: 2021.05.05
01:14:28 +02'00'

Rem brand
Dine

Digitally signed by Rem brand
Dine
Date: 2021.05.05 10:56:21
+02'00'

SHPJEGUES :

PARCELA
 NDERTESA

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria
Vendore Vlorë)